

**RAPORTI I DYTË I NDËRMJETËM**  
**“VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE LOKALE TE 21 QERSHORIT 2015”**

**Tiranë, Shqipëri 19 Qershor 2015**  
**Raporti mbulon punën e kryer nga skuadra e 90 vëzhguesve afatgjatë dhe të angazhuar**  
**nga Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e për Demokraci të Qendrueshme**  
**Nga data 6 qershor – 13 qershor 2015**



*Ky raport u realizua në kuadër të projektit: Vëzhgimi i Zgjedhjeve Lokale të 21 Qershorit 2015 në Shqipëri”. Projekti i KZLNQ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21 Qershor 2015 mbështetet nga Assist Impact nëpërmjet fondeve të USAID-it. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e Qendrës “Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e për Demokraci të Qëndrueshme” dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht këndvështrimin e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Nderkombëtar (USAID) apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.*

Të drejtat e publikimit

©Aplikimet për lejen për të riprodhuar ose përkthyer të gjithë apo një pjesë të këtij manuali duhet të bëhen në:

Zyrën e Koalicionit për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e për Demokraci të Qëndrueshme

Rr.“Abdyl Frashëri”, P.10/1, shk.1, ap.3, Tiranë, Shqipëri

e-mail: [kzln@kzln.org.al](mailto:kzln@kzln.org.al)

[ëëë.kzln.org.al](http://ëëë.kzln.org.al)

## *Tabela e Përmbajtjes*

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	<b>4</b>
<b>1. ADMINISTRATA ZGJEDHORE</b> .....	<b>7</b>
1.1 PROCEDURALITETI DHE VENDIMMARRJA E KZAZ-VE .....	7
1.2 ZËVENDËSIMI I KOMISIONERËVE TË ZAZ-VE .....	8
1.3 INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA, ANA MATERIALE DHE BUXHETI .....	8
1.4 QENDRAT E VOTIMIT .....	9
<b>2. FUSHATA ZGJEDHORE</b> .....	<b>10</b>
3. INSTITUCIONET PUBLIKE DHE PËRDORIMI I BURIMEVE PUBLIKE NË KONTEKSTIN E ZGJEDHJEVE VENDORE 2015 .....	11
<b>3. KUSH ËSHTË KZLNDQ</b> .....	<b>14</b>
ANEKSI 1 TABELA E KZAZ-VE NË TË GJITHË SHQIPËRINË.....	15



## Përmbledhje Ekzekutive

Në 22 maj 2015 Koalicioni për Zgjedhje të Lira, të Ndershme dhe për Demokraci të Qëndrueshme stacionoi 90 vëzhgues afatgjatë (VAGJ) për secilin nga 90 Zonat e Administrimit Zgjedhor (ZAZ) për të vëzhguar procesin parazgjedhor të Zgjedhjeve Lokale të 21 Qershorit 2015. Gjetjet kryesore lidhur me punën e administrates zgjedhore, mbarëvajtjen e fushatës zgjedhore, punën e institucioneve publike dhe abuzimit me burimet administrative për periudhen 7 qershor deri me 13 qershor janë si më poshtë:

### *Administrata Zgjedhore*

- Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) në 90 Zonat e Administrimit Zgjedhor (ZAZ) në Shqipëri organizuan mbledhjet në një atmosferë përgjithësisht të qetë dhe bashkëpunuese. Megjithatë, mbledhjet e KZAZ ishin të rralla në shpeshësi dhe nuk plotësuan afatet dhe kriteret e kërkuara nga legjislacioni mbi mbajtjen e mbledhjeve. Katër KZAZ nuk mbajtën asnjë mbledhje zyrtare në këtë periudhë raportimi. Vëzhguesit e KZLN-DQ-së në disa raste hasën vështirësi në marrjen e procesverbalit të mbledhjes nga KZAZ-ja që kishte organizuar mbledhje dhe nëntëmbëdhjetë (19) KZAZ nuk i bënë publike vendimet që u moren dhe nuk dhanë asnjë informacion mbi punën e tyre, gjë që bie në kundërshtim me legjislacionin<sup>1</sup>.
- Gjatë 17 ditëve të para të Qershorit u zëvendësuan 79 komisionerë<sup>2</sup>. Partia Socialiste (PS) ka bërë më shumë zëvendësime 47 në total, duke u ndjekur nga Partia Demokratike (PD) me 20 zëvendësime; Partia Republikane (PR) me 9 zëvendësime dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) me 3 zëvendësime. Shkalla e lartë e zëvendësimeve cënon rëndë procesin zgjedhor, ku komisionerë të rinj përfshihen në pikun e procesit veç pak ditë para Ditës së Zgjedhjeve.
- Njëzet KZAZ vazhdojnë të kenë mungesë ose pamjaftueshmëri në buxhet dhe materiale. KQZ ka caktuar një shumë fikse prej 15000 lekësh e cila është shpërndarë me vonesë. Sipas komisionerëve të ZAZ-ve, kjo shumë nuk është e mjaftueshme për të plotësuar kërkesat e KZAZ-ve, dhe mendojnë që shuma duhet të variojë nga ZAZ-ja në ZAZ në bazë të numrit të Qendrave të Votimit dhe specifikave gjeografike.
- Partitë Politike vazhdojnë të pengojnë procesin duke vonuar listen me emrat e komisionerëve për Qendrat e Votimit QV. Tridhjetëegjashmë (36) KZAZ nuk respektuan afatet ligjore e 1 Qershorit 2015, për të formuar komisionet e QV dhe 7 KZAZ<sup>3</sup> akoma nuk e kanë përfunduar procesin, deri në datën e 13 Qershorit.

<sup>1</sup>Udhëzimi nr. 2 i KQZ me datë 25.02.2009, Neni 22.6 pohon që: "KZAZ-të janë të detyruara që të bëjnë publike menjëherë vendimet e marra ..."

<sup>2</sup>Një numër prej 208 komisionerësh janë zëvendësuar deri tani (79 në Qershor, 85 në Maj dhe 44 në Prill). Burim: vendimet e KQZ-së

<sup>3</sup>CEAZs 1, 48-50, 59, 70, 66. For the location of CEAZs, see Annex 1.

- Qendrat e Votimit në mbarë vendin janë të paaksesueshme (mungesë pjerrinash dhe ashensorësh) dhe nuk plotësojnë standardet ndërkombëtare për të mundësuar votimin e personave me aftësi të kufizuar dhe për të siguruar që këta persona mund të ruajnë fshehtësinë e votes në kutinë e votimit.
- Partitë Politike gjithashtu kanë penguar procesin e ngritjes së grupeve të numërimit (GN). Në njëzet (20) KZAZ, grupet e numërimit u ngriten pas afateve ligjore të 11 qershorit 2015, kryesisht pasi partitë politike i vonuan listat e emrave të numëruesve.

### ***Fushata Zgjedhore***

- Fushata zgjedhore është intensifikuar gjatë periudhës së raportimit, por me përjashtim të disa incidenteve të izoluar, ka qenë përgjithësisht e qetë.
- Liderët e tre partive kryesore dominojnë podiumet duke eklipsuar kandidatët në garë, ndërsa anëtarët në listat për këshillat bashkiak mbeten në hije dhe nuk promovohen aspak. Prandaj, qytetarët kanë pak informacion mbi vendimmarrësit e ardhshëm të cilët do të hartojnë politikat e bashkive të tyre.
- Kandidatët kanë bërë përpjekje të konsiderueshme në paraqitjen e platformave të tyre, por premtimet mbeten të përgjithshme dhe nuk shoqërohen me plane të detajuara për zbatim. Në disa raste, kandidatët për kryetarë bashkie i referohen politik-bërjes në nivel kombëtar në platformat e tyre.
- Aspekti pamor i propagandes zgjedhore është rritur gjatë periudhës së raportimit. Përdorimi i rrjeteve sociale mbetet i madh, ku kandidatët mbulojnë aktivitetet e tyre në llogaritë personale.
- KZLNDQ vëren një shtim të sulmeve personale ndaj kandidatëve. Këto raste janë pare në Shkodër, Durrës dhe Vlorë. Në një rast KQZ ka ndërhyrë duke urdhëruar një organ të medias që ti jepte fund mesazheve denigruese kundër dy kandidatëve në Vlorë.
- Gjatë kësaj periudhe raportimi janë vënë re disa incidente kundër kandidatëve, zyrave zgjedhore dhe posterave të partive politike/kandidatëve përfshirë rastin e dhunimit të zyrave dhe posterave zgjedhor të Partisë së Bashkimit për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ) në Himarë dhe mesazhet kërcenuese për kandidatin e PD-s në Pogradec, Eduard Kapri. Prokuroria po heton çështjen e kandidatit të PD-së.

### ***Institucionet publike dhe abuzimi me burimet administrative***

Në këtë periudhë raportimi, ka pasur akuza për gjashtë raste ku punonjës të administrates publike iu është ushtruar presion për të marrë pjesë në aktivitete elektorale të partive politike dhe kandidatëve, ndërsa vazhdojnë të regjistrohen rastet mbi dhënien e ndihmave familjeve të përmytura në Nëntor të vitit 2014.

- Një aspekt tjetër i fushatës është përdorimi i inagurimeve të punëve të rëndësishme publike nga zyrtarë publik dhe anëtarë të qeverisë, gjë që ndihmon fushatën e koalicionit qeverisës. Raste të tilla janë vënë re në Fier dhe Divjakë.
- Ka pasur disa raste të përdorimit të hapësirave publike nga partite pa marrë miratimin e autoriteteve lokale, gjithashtu dhe akuza për dhënie të padrejtë të hapësirave publike nga këto autoritete.
- Koalicioni shpreh shqetësim mbi akuzat e shumta mbi blerjen e votive gjatë javës së kaluar, në veçanti në bashkinë e Vorës dhe thekson, në rast se është e vërtetë, këto veprime përbëjnë shkelje penale. Parakushti për mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe të nderëshme dhe krijimin e besimit në proceset elektorale është që të gjithë ata që kryejnë vepra penale në lidhje me të drejtat dhe rregullat zgjedhore dënohen sipas ligjit. Prandaj, KZLN-DQ i bën thirrje autoriteteve përgjegjëse që të hetojnë mbi këto akuza dhe të informojnë qytetarët sa më parë rreth rezultateve të hetimit për rastet e akuzave të blerjes së votes.

## 1. Administrata Zgjedhore

### 1.1 Proceduraliteti dhe vendimmarrja e KZAZ-ve

Nëntëdhjetë (90) vëzhguesit e KZLNDQ kanë ndjekur aktivitetin e KZAZ-ve gjatë periudhës 7 -13 qershor. Ata morën pjesën në 154 mbledhje nga 188 mbledhje gjithsej. Katër nga KZAZ-të e vëzhguara nuk kanë kryer asnjë mbledhje gjatë kësaj periudhe raportimi.<sup>4</sup>

Mbledhjet e KZAZ-ve kanë qenë kryesisht të qeta dhe të karakterizuara nga fryma e bashkëpunimit. Por vazhdon ende mosrespektimi i kritereve ligjore për mbarëvajtjen e mbledhjeve. Në pothuajse gjysmën e KZAZ-ve, janë kryer vetëm një ose asnjë mbledhje. Kjo nuk do të thotë se KZAZ-të nuk po punojnë (kjo vihet re nga fakti që në këto KZAZ vazhdon puna në terren për mbikëqyrjen e qendrave të votimit dhe përgatitjeve për ditën e votimit) , porse një pjesë e mirë e vendimmarrjes kryhet jashtë zyrave të tyre (me anë të telefonatave apo mbledhjeve jashtë zyre). KZLNDQ konstaton nga raportimet në terren se një pjesë e KZAZ-ve mblidhen në zyre vetëm për nënshkrimin e vendimeve të marra.

KZLNDQ vëren se nëntëmbëdhjetë (19<sup>5</sup>) KZAZ vazhdon të mos bëhen publike vendimet e marra, apo edhe çdo lloj informacioni në lidhje me punën e KZAZ-së. Këtu nuk ndihmon as Kodi Zgjedhor ku shpallet se KZAZ-ja duhet të bëjë menjëherë publike vendimet e marra<sup>6</sup>, por nuk specifikon mënyrën/at për të bërë publike vendimet.

Për më tepër, vëzhguesit e KZLNDQ kanë hasur në disa vështirësi gjatë monitorimit të KZAZ-ve përkatëse. Këto KZAZ nuk lajmëronë në kurrfarë mënyre kohën dhe axhendat e mbledhjeve. Vëzhguesit kanë pasur gjithashtu problem me marrjen e kopjeve të vërtetuara të procesverbaleve të takimeve të KZAZ-ve, edhe pse Kodi Zgjedhore, Neni 34, paragrafi ë, përcakton se sekretari i KZAZ-së duhet t'i pajisë subjektet zgjedhore dhe palët e treta, pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga bërja e kërkesës, kopje të vërtetuara të vendimeve ose procesverbaleve të mbledhjeve.

<sup>4</sup> KZAZ 44, 78,79, 90. Për vendndodhjen e KZAZ-ve, shih Aneksin 1.

<sup>5</sup> KZAZ 3, 7-8, 16, 18-20, 23, 28, 30, 36, 38, 48-50, 56, 68, 74, 83. Për vendndodhjen e KZAZ-ve, shih Aneksin 1.

<sup>6</sup> Udhëzimi nr. 2 i KQZ-së, dt. 25.2.2009, Neni 22/6 përcakton se: "KZAZ është e detyruar që të bëjë menjëherë publike vendimet e marra..."

### **1.2 Zëvendësimi i komisionerëve të ZAZ-ve**

KZLNDQ vëren e shqetësuar valën e ndërrimeve të komisionerëve të ZAZ-ve gjatë periudhës së raportimit, e cila pasqyron besnikërisht prirjen e partive në javët paraardhëse. Kështu, me anë të Vendimit 648 të KQZ-së, dt. 15.06.2015, u ndërruan shtatëmbëdhjetë komisionerë të ZAZ-ve. Vendimi 669 i dt. 17 qershor miratoi zëvendësimin e njëzetë e gjashtë komisionerëve të tjerë. Gjatë 17 ditëve të para të qershorit janë ndërruar 79 komisionerë<sup>7</sup>, ku kryeson ndjeshëm Partia Socialiste (PS) me 47 zëvendësime, e pasuar nga Partia Demokratike (PD) me 20, Partia Republikane (PR) me 9 dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) me 3 zëvendësime.

Brenda qershorit, PS ka ndërruar numrin e plotë të komisionerëve të saj në tetë (8<sup>8</sup>) KZAZ. Kjo valë zëvendësimesh ngre pikëpyetje të mëdha për aftësinë e zëvendësuesve për të përmbushur detyrat, pasi vetëm tre prej tyre janë ndërruar përpara trajnimit të fundit nga ana e KQZ-se në dt. 2-4 qershor. Nga ana tjetër, nisur nga takimet që vëzhguesit e KZLNDQ kanë pasur me partitë, këto garantojnë se komisionerët e rinj kanë eksperiencë në postin që mbulojnë, pasi kanë mbuluar detyra të ngjashme në zgjedhjet e kaluara. Këto zëvendësime nuk e ndihmojnë procesin, pasi komisionerët e rinj, pavarësisht përvojës së mëparshme, prezantohen në specifikat e ZAZ-së, të cilat ndryshojnë nga zgjedhje në zgjedhje. Për më tepër, numri i lartë i zëvendësime është i pajustificueshëm për ndikimin që ka në proces.

### **1.3 Infrastruktura, logjistika, ana materiale dhe buxheti**

Gjatë periudhës 6-13 qershor vazhdojmë të kemi tetë (8) KZAZ që vuajnë mungesën e infrastrukturës dhe logjistikës dhe tre<sup>9</sup> KZAZ nuk kanë ende lidhje me internet, kur jemi fare pranë ditës së zgjedhjeve. KZLNDQ është e mendimit që KQZ duhet të bashkërendojë punën e saj me autoritetet lokale, që këto të fundit të plotësojnë, brenda mundësive, logjistikën e KZAZ-ve.

Vazhdon të jetë i lartë numri i KZAZ-ve që kanë mungesa në materiale dhe buxhet, dy zëra të lidhura ngushtë. Sipas raportimeve të vëzhguesve të KZLNDQ, kemi 20 KZAZ të cilat shprehen për mungesë ose pamjaftueshmëri buxheti dhe mungesë në materiale. KQZ alokoi pranë bashkive buxhetet përkatëse për KZAZ-të. Nga të dhënat e nxjerra nga vëzhguesit, KZAZ-ve u është dhënë një shumë fikse prej 15000 lekë (të reja), kryesisht për shpenzime mbi zëra si letra dhe bojë. Ky fond është i pamjaftueshëm për punën e KZAZ-ve, sidomos kur vjen puna të transporti dhe furnizimi me karburant. Në këtë drejtim, nevojat buxhetore

<sup>7</sup> Në total janë ndërruar 206 komisionerë (79 në qershor, 85 në maj dhe 44 në prill). Burim: Vendimet e KQZ-së.

<sup>8</sup> KZAZ 21, 22, 27, 33, 57, 82, 83, 84. Për vendndodhjen e KZAZ-ve, shih Aneksin 1.

<sup>9</sup> KZAZ 37 (Nj. Bashkiake 7, Tiranë), KZAZ 39 (Nj. Bashkiake 9, Tiranë) dhe KZAZ 56 (Divjakë)



luhaten jashtëzakonisht nga njëra KZAZ tek tjetra, në bazë të numrit<sup>10</sup> vendndodhjes<sup>11</sup> të qendrave të votimit (QV) për secilën KZAZ.

Për shkak të mungesës së fondeve për karburant, disa KZAZ nuk kanë mundur ende të mbarojnë inspektimin e QV dhe disa prej tyre ende nuk i kanë të afishuara listat e votuesve<sup>12</sup>.

Është e rëndësishme të vëmë në dukje se fondi prej 15000 lekë u shpërnda nga KZAZ në dt. 04.06.2015, pothuajse dy muaj nga mbledhja e pare e KZAZ-ve në 14 prill dhe 24 ditë nga publikimi dhe afishimi i listave përfundimtare të zgjedhësve.

#### 1.4 Qendrat e Votimit

Vëzhguesit e KZLNQ raportojnë gjithashtu mbi ecurinë e përgatitjeve të QV-ve. Deri më 17 qershor, KZAZ 34 në Tiranë nuk ka arritur ende të caktojë komisionarët në 68 QV<sup>13</sup>. Në shtatë (7<sup>14</sup>) KZAZ, deri në dt. 14 qershor nuk kishte përfunduar ende procesi i caktimit të komisioneve përkatëse për QV-të, pavarësisht se afati ligjor<sup>15</sup> ishte në dt. 01.06.2015. Në këto ZAZ, komisionarët citojnë si arsye të vetme vonesat në dorëzimin e listave të komisionerëve për QV-të nga ana e partive, mungesën në dokumentacion dhe numrin e lartë të kandidatëve për komisioner që nuk përmbushin kriteret<sup>16</sup>.

Gjithashtu janë konstatuar një sërë QV me problem: QV të vendosura në shtëpi banimi<sup>17</sup> apo në ambiente me infrastrukturë të papërshtatshme ose në rikonstruksion<sup>18</sup>.

KZLNQ shpreh shqetësimin se pjesa dërrmuese e QV në Shqipëri nuk kanë infrastrukturën e përshtatshme për votuesit me aftësi të kufizuara, duke rënë ndesh me kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe me standardet kombëtare që personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të shprehin vullnetin e tyre politik

#### 1.5 Vendet e Numërimit të Votave dhe Grupet e numërimit

<sup>10</sup> Shembull: ZAZ 64 (Berat), është më e madhja (jo për votues) në vend me 124 QV, në zonë urbane dhe zona rurale, ndërsa ZAZ 64 (Pustec), është më e vogla në vend, me vetëm 8 QV.

<sup>11</sup> Shembull: Bashkia Shkodër ka katër ZAZ (2, 3, 4, 5). ZAZ-të 3, 4, 5 kanë përkatësisht 46, 44, 45 QV, të gjitha në qytetin e Shkodrës. ZAZ 2, me qendër në Shkodër, ka 110 QV, të gjitha në zonat rurale, disa prej të cilave në zona të thella malore dhe me infrastrukturë ndërlidhëse të dobët.

<sup>12</sup> Shembull: KZAZ 2 nuk ka mundur të afishojë listat e votuesve në 13 QV: QV 91-94 (Komuna Pult), QV 115-119/1 (Shalë) dhe QV 132-134 (Shosh); KZAZ 13 nuk ka mundur të afishojë listat në 27 QV: QV 690-696 (Blinisht), QV 704-708 (Kallmet) dhe QV 720-728 (Kolsh).

<sup>13</sup> Në 17 qershor vëzhguesi ynë raportoi, pas një takimi me kryetarin e KZAZ-së, se komisioni ende po priste dorëzimin e listës së komisionerëve nga Partia Demokratike. Ndërkohë, Partia Socialiste e kishte dorëzuar listën përkatëse vetëm një ditë më parë.

<sup>14</sup> KZAZ 1, 48-50, 59, 70, 66. Për vendndodhjen e KZAZ-ve, shih Aneksin 1

<sup>15</sup> Kodi Zgjedhor, Neni 36/2: "...Në çdo rast, emërimi i anëtarëve dhe sekretari bëhet jo më vonë se 20 ditë para datës së zgjedhjeve."

<sup>16</sup> Kodi Zgjedhor, Neni 37 "Papajftueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe sekretarit të KQV-së".

<sup>17</sup> Shembull: KZAZ 71 (Korçë), QV 3717 Shtëpi Banimi (Lekas, Gurmujažë). Sipas Kodit Zgjedhor, Neni 93/2/a "Qendrat e votimit, selitë e KZAZ-ve dhe Vendi i Numërimit të Votave nuk mund të krijohen në: ndërtesa private, pa vendim të KQZ-së. Në çdo rast qendra e votimit nuk mund caktohet në banesa private." KZAZ-të kanë vepruar në këtë drejtim duke zhvendosur pothuajse të gjitha ato QV të vendosura në ambiente banimi.

<sup>18</sup> Shembull: KZAZ 41 (Nj. Bashkiake 11, Tiranë) QV 2015,2015/1, 2013,2013/1, 2016,2016/1, 2028,2028/1, 2029,2029/1, 2014,2014/1. Sipas informacioneve të fundit nga KZAZ, të gjitha këto qendra do të zhvendosen.

Vëzhguesit e KZLNDQ raportojnë se në njëzetë (20) KZLNDQ procesi i krijimit të Grupeve të Numërimit (GN) përfundoi pas afatit ligjor të dt. 11.06.2015<sup>19</sup>. Edhe në këto raste, shkaku i kryesor i mosrespektimit të afatit ishin vonesat e shkaktuara nga partitë politike, të cilat vonuan dorëzimin e listave me emrat e numëruesve, ose dorëzuan lista me probleme, si në mungesë dokumentacioni, ashtu edhe me kandidatë që nuk i përmbushnin kriteret.

Procesi për pajisjen e Vendeve të Numërimit të Votave (VNV) me logjistikën e nevojshme (tavolina, ekrane skanimi) dhe vetëm në KZAZ-në 19 (Dibër) është shënuar mungesa e kësaj logjistike.

## 2. Fushata zgjedhore

Fushata për zgjedhjet vendore të 21 Janarit u intensifikua gjatë periudhës së raportimit, por me përjashtim të disa incidenteve të izoluar, ajo mbeti përgjithësisht e qetë.

Tonin fushatës vazhdojnë t'ja japin dy koalicionet, ai i Aleancës për Shqipërinë Evropiane (ASHE, udhëhequr nga PS) dhe ai i Aleancës Popullore për Punë dhe Dinjitet (APPD, udhëhequr nga PD). Kandidatët e pavarur kanë mbetur në hije për shkak të mitingjeve dhe aktiviteteve në përmasa të vogla, si dhe mbulimit në shkallë më të ulët nga media, si rezultat i burimeve financiare dhe strukturore të kufizuara.

Mitingjet elektorale vazhduan me intensitet ku liderat e partive dhe ekipet mbështetëse lëviznin nga një qytet në tjetrin.

U rikonfirmua edhe këtë javë angazhimi i plotë në fushatë e kryetarëve të tre partive më të mëdha PS, PD e LSI, duke zënë vendin kryesor ndërsa promovonin kandidatët respektivë për kryetar. KZLNDQ mendon se kjo shoqërohet me dy aspekte negative. E para, ata kontribuojnë në polarizimin e mëtejshëm të garës zgjedhore mes kandidatëve vendorë dhe dëmtojnë rëndësinë e kandidatëve vendorë në garë. Së dyti, ata bëjnë premtime të nivelit kombëtar, nga pozitat ku janë, si lider të partive.

Kjo qasje, sipas KZLNDQ, është influencuar, gjithashtu, nga TV kombëtare dhe lokale që ndjekin turet e liderve dhe harrojnë (ose i raportojnë pak) takimet që bëjnë kandidatët në zona periferike apo takimet me grupe të vogla. Këtu bën përjashtim Tirana dhe Durrësi pasi veprimtaria e kandidatëve të koalicioneve është pasqyruar gjerësisht.

Platformat zgjedhore janë përpunuar më tej, por CFFESD vëren se premtimet mbeten të përgjithshme dhe nuk janë shoqëruar me planet e detajuara për zbatimin. CFFESD beson, fuqimisht, se është e nevojshme për të shpjeguar për qytetarët mjetet për realizimin e premtimeve elektorale të programit, duke përfshirë institucionet kompetente, rregulloret, fondet e nevojshme dhe afatet për përmbushjen e tyre. Në disa raste, kandidatët për kryetarë nga të dy koalicionet i referohen nivelit kombëtar të politikbërrjes në platformat e tyre.

Vazhdon e njëjta situatë, si në raportin e parë, ku kandidatët e këshillave bashkiake nuk shihen të shoqërojnë kandidatët për kryetar bashkie në takimet publike. E njëjta gjë mund të thuhet për shtrirjen e aktivitetit elektorale të kandidatëve në zonat ku banon komuniteti Rom apo Egjiptian.

<sup>19</sup> Kodi Zgjedhor, Neni 95/1.

Në javën që mbulon raporti u theksua edhe më shumë forma vizuale e propagandës elektorale. Janë shtuar në mënyrë të konsiderueshme flamujt partiakë, posterat e kandidatëve respektive dhe pankartat. Sipas vëzhgimeve të VAGj, përgjithësisht, koalicioni i majtë është më i dukshëm për sa i përket materiale propagandistike, vecanërisht në Peqin, Gramsh, Pogradec, Sarandë, Himarë, Berat, Fier e Kavajë.

Përdorimi i rrjeteve sociale vazhdon të mbetet i preferuar, ku kandidatet ofrojnë mbulimin e evenimenteve në llogaritë respektive të medias sociale.

Gjatë kësaj periudhe monitorimi, KZLN DQ ka vënë re se janë rritur rastet e sulmeve personale ndaj kandidateve. Të tilla janë rastet e Shkodrës ku te dyja kandidatet Keti Bazhdari (ASHE)<sup>20</sup> dhe Voltana Ademi (APPD)<sup>21</sup> janë përballur me foto dhe mesazhe denigruese. Vëzhguesit tanë në Durrës ka vënë re që, Znj. Grida Duma (APPD) qëllimisht ka keqshqiptuar emrin e kandidatit të koalicionit qeverisës, Z. Dako në aktivitetet e saj elektorale. Ndërsa vëzhguesit tanë në Vlorë informojnë që kandidati i pavarur Vasil Bedinaj<sup>22</sup> ka perdorur, në disa raste, fjalor denigrues për drejtuesit e lartë të vendit. Në përgjigje të kësaj, i njëjti kandidat ishte subjekt i mesazheve denigruese në TV Vlora, që gjithashtu transmetoi mesazhe denigruese ndaj kandidatit të koalicionit të djathtë Z. Genc Deromenaj. Është me rëndësi të shënojmë këtu, që KQZ udhëroi mediat ti japin fund kësaj praktike.

Këtë javë kanë ndodhur një numër incidentesh ndaj kandidatëve, zyrave zgjedhore dhe posterave. Më flagrant paraqitet rasti i dhunimit të zyrës elektorale të Partisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Himarë, përfaqësuese e minoritetit Grek, dhe grisjes së posterave të kandidatit të saj Fredi Beleri (PBDNJ).

Në një tjetër incident, stafi i kandidatit të PD në Pogradec, Z. Eduart Kapri, raportoi se ai ka marrë një mesazh kërcënues në telefonin e tij celular. Prokuroria po e heton, tashmë, këtë rast. Në Vlorë kandidati i pavarur Vasil Bedinaj<sup>23</sup> denoncon presionin nga ana e pushtetit ndaj tij dhe bashkëpunëtorëve të tij në shprehjen e lirë të ideve të tyre.

Rikonfirmohet sjellja profesionale e forcave të policisë gjatë fushatës. KZLN DQ i inkurajon ato që të vazhdojnë me këtë sjellje korrekte.

KZLN DQ vazhdon t'ju bëjë thirrje të gjithë kandidatëve dhe partive të zbardhin të dhënat financiare dhe kontributet nga donatorët për fushatat respektive zgjedhore, si një detyrim dhe përgjegjësi politike përpara votuesve.

### ***3. Institucionet publike dhe përdorimi i burimeve publike në kontekstin e Zgjedhjeve Vendore 2015***

Gjatë kësaj periudhe raportimi ka pasur gjashtë<sup>24</sup> raste ku akuzohet se është ushtruar presion mbi administratën publike për të marrë pjesë në aktivitetet e fushatës zgjedhore të partive politike dhe kandidatëve. Në Urën Vajgurore (ZAZ 62), kandidati i Partisë Demokratike (PD) pretendon se është ushtruar presion ndaj nëpunësve të administratës publike për të marrë

<sup>20</sup>[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=361086360769337&id=167888386755803](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=361086360769337&id=167888386755803)

<sup>21</sup><http://www.gazetatema.net/ceb/2015/05/30/foto-lajm-voltana-ademi-nje-incident-hot/>

<sup>22</sup>[https://video-fra3-1.xx.fbcdn.net/hvideo-xtf1/v/t42.1790-2/11275256\\_431189900375754\\_846240387\\_n.mp4?oh=5aaa7aa275b7407fbb07c8607a034725&co=557B655F](https://video-fra3-1.xx.fbcdn.net/hvideo-xtf1/v/t42.1790-2/11275256_431189900375754_846240387_n.mp4?oh=5aaa7aa275b7407fbb07c8607a034725&co=557B655F)

<sup>23</sup><https://www.facebook.com/GazetaRD/photos/pcb.801559349942316/801559046609013/?type=1&theater>

<sup>24</sup> Tirana, Ura Vajgurore, Berat, Poliçan, Pogradec, Vlora, Selenica.

pjesë në aktivitetet e fushatës së koalicionit të majtë. Po kështu, në Berat (ZAZ 64), kryetari i fushatës së PD-së argumenton se po ushtrohet presion mbi të gjithë administratën e Beratit për të mbështetur fushatën e kandidatit të Aleancës për Shqipërinë Evropiane (ASHE).

Gjithashtu, në Selenicë (ZAZ 85) nëpunësit publikë, mësuesit dhe personeli spitalor janë shprehur se kanë marrë pjesë në aktivitetet e kandidatit të ASHE, nën presionin e humbjes së vendit të punës. KZLNDQ shpreh shqetësimin e saj mbi këtë dukuri, aq më shumë për faktin se tre raste (Ura Vajgurore, Pogradec dhe Vlorë) nga gjashtë rastet e përmendura më sipër janë vënë në dukje edhe në Raportin e Parë të Ndërmjetëm të KZLNDQ.

Nga ana tjetër, janë vëzhguar gjashtë<sup>25</sup> raste ku nëpunësit e Qeverisë së Shqipërisë, nëpunës të administratës publike qendrore dhe vendore dhe të agjencive publike mbështesin në fushatë kandidatët dhe partitë politike gjatë orarit të punës. KZLNDQ vë në dukje rastin e Vlorës, ku nëpunësit e Bashkisë Vlorë, punonjës të Ujësjellësit dhe Kanalizimeve dhe personeli spitalor kanë marrë pjesë në aktivitetet zgjedhore të kandidatit të majtë gjatë orarit të punës. Këto raste janë raportuar edhe nga media lokale në Vlorë. Për më tepër, në Poliçan (EAZ 65), nëpunësit e bashkisë, por edhe drejtori i shkollës së mesme janë parë gjatë orarit të punës duke shoqëruar kandidatin e ASHE në aktivitetet zgjedhore të këtij të fundit në Paraspuar dhe Rehovë, në orën 10:30 të datës 2 qershor. Po kështu, në Himarë (ZAZ 86), në orën 11:30, 5 qershor, kryetari aktual i bashkisë ka mbajtur një takim fushate në lagjen “1 Maji” në praninë e një pjese të nëpunësve të Bashkisë Himarë.

KZLNDQ shpreh shqetësimin mbi rastet në fjalë, të cilat përbëjnë qartazi shkelje të Nenit 3/7 të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohet se subjektet zgjedhore nuk mund të përdorin burimet njerëzore të administratës publike të çdo niveli. KZLNDQ fton partitë politike të tregojnë transparencë për ato raste kur individët e punësuar në administratën publike marrin pjesë në fushatë

Gjatë kësaj periudhe raportimi, KZLNDQ vëren përsëri një numër rastesh ku shpërndahet ndihmë ekonomike për familjet e përmbytura në nëntor 2014. Për shembull në Urën Vajgurore raportohet se më datë 11.06.2015m ora 16:00-18:30, pranë bashkisë u shpërndanë ndihma për të përmbyturit. I njëjti fenomen raportohet në Novoselë, Vlorë, ku janë shpërndarë ndihma në ushqime, e raportuar edhe në mediat lokale. Ky fenomen mbetet shqetësues për KZLNDQ pasi përzgjedhja e kohës për të ndarë këto ndihma mund të përbëjë një tendencë për të ndikuar mbi votën e përfituesit. Kjo tendencë bie ndesh me parimin e votës së lirë të mbështetur në Kodin Elektorale të Republikës së Shqipërisë dhe në standardet ndërkombëtare.

Një tjetër aspekt i fushatës është përdorimi i inaugurimit të veprave publike nga politikanët dhe parlamentarët për të ndihmuar fushatën e koalicionit në fuqi. Dalin në pah dy raste në Fier dhe Divjakë. Në Fier, mitingu permbylles i organizuar nga ASHE, me pjesëmarrjen e kryeministrit Edi Rama, nisi me inaugurimin e shetitores së qytetit, një investim publik që nuk duhet lidhur me fushatën vendore. Në Divjakë, në 8 qershor, z. Erion Brace, pjesëtar i grupit parlamentar të PS, perdori ceremoninë e hapjes së sezonit turistik në Divjakë për të bërë fushatë për kandidatin e ASHE.

<sup>25</sup> Ura Vajgurore, Poliçan, Vlorë, Selenicë, Humarë.

Ka pasur nje numer te kufizuar rastesh te perdorimit nga ana e partive te hapësirave publike pa lejen e autoriteteve vendore, por edhe raste ku partite dhe kandidatet akuzojn autoritetet vendore per nje shperndarje jo te drejte te hapësire publike.

KZLNDQ ve ne dukje nje numer akuzash nga partite per ndarjen e padrejte te hapësires publike qe kandidatet te postojne materialet propagandistike. Ne Vlore, koalicioni i djathte dhe kandidati i pavarur akuzuan nepermjet mediave vendore se kandidati i ASHE gezon me shume hapësira per te postuar materialet propagandistike. Gjithashtu, kandidati i PD-se ne Uren Vajguore deklaroi per KZLNDQ se nuk i eshte dhene hapësire e barabarte per te vendosur materialet propagandistike.

Ka pasur gjithashtu raste kur partite politike kane perdorur hapësirat publike pa autorizim, por se autoritetet vendore kane reaguar shpejt dhe me efikasitet. Ne Bulqize, me dt.

11.06.2015, Partia Demokratike vendosi postera dhe flamuj ne Pallatin e Kultures, ku jane vendosur zyrtat e KZAZ 18. Keto materiale propagandistike u hoqen mengjesin e te nesermes, pas ankeses se perfaqesuesve te Levizjes Socialiste per Integrim kundrejt kryetarit te bashkise per nje ndarje te pabarabarte te hapësires publike per postimin e materialeve propagandistike. KZLNDQ shpreh shqetësimin për pretendimet e shumta gjatë javës së kaluar për përpjekje për blerjen e votave, veçanërisht për rastin në Bashkinë Vorë, dhe vë në dukje se, nëse këto raste janë të vërteta, atëherë përbëjnë nje vepër penale.

KZLNDQ nuk është në gjendje të verifikojë saktësinë e këtyre akuzave, por u bën thirrje autoriteteve përkatëse të hetojnë menjëherë pretendimet dhe të informojnë sa më shpejtë qytetarët mbi përfundimet e nxjerra nga hetimet e rasteve që kanë të bëjnë me blerjen e votës. Një nga kushtet paraprake për mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme dhe për ndërtimin e besimit në procesin zgjedhor është se të gjithë ata që kryejnë vepra penale në kontekstin e të drejtës dhe ligjit zgjedhor duhet të ndëshkohen në përputhje me ligjin.

### 3. Kush është KZLNDQ

*Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e Demokraci të Qendrueshme (KZLNDQ) është një koalicion i pavarur, jopartiak, i krijuar me qëllim nxitjen e pjesmarrjes së qytetarëve në votime dhe vëzhgimin e proceseve zgjedhore. KZLNDQ i kushton vëmendje të veçantë të drejtave të njeriut para ligjit, çështjeve që ndikojnë tek votuesit me aftësi të kufizuara si dhe çështjet e barazisë gjinore.*

*KZLNDQ ka nënshkruar Deklaratën Globale të Parimeve të Vëzhgimit Zgjedhor të Paanshëm nga Qytetarët dhe Kodin e Sjelljes të GDNEM ( Rrjetit Global të Vëzhguesve Vendas për Monitorimin e Zgjedhjeve, që parashtron qartësisht parimet dhe kodin e sjelljes për monitorimin e pavarur të zgjedhjeve nga organizatat qytetare.*

*Metodologjia e vëzhgimit të zgjedhjeve të KZLNDQ është në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare bazuar në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Dokumenti i Kopenhagenit i OSBE-së, Konventa e OKB për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Deklarata e Parimeve Globale për Vëzhgimin e Paanshëm.*

*Projekti i KZLNDQ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21 Qershor 2015 mbështetet nga Assist Impact nëpërmjet fondeve të USAID-it. Në procesin e vëzhgimit të Zgjedhjeve Lokale në Shqipëri 2015, KZLNDQ po asistohet teknikisht nga Instituti Demokratik Amerikan, NDI.*

*KZLNDQ, bazuar në të dhënat e datës 6 qershor 2015, përbëhet nga 30 organizata partnere dhe nga qindra vullnetarë në të gjithë Shqipërinë.*

*Për më shumë informacion, ju lutemi të shihni portalin online [ëëë.kzln.org.al](http://ëëë.kzln.org.al) ose të kontaktoni:*

*Mirela Arqimandriti, drejtuese e projektit të vëzhgimit të zgjedhjeve.*

*Erjona Mulellari, drejtore ekzekutive.*

*Dhimëtr Gjodede, koordinator i vëzhguesve afatgjatë*

*Email: [kzln@kzln.org.al](mailto:kzln@kzln.org.al) Cel: 00355 68 20 59 301 ; 0684046770*

*Ëbsite: [ëëë.kzln.org.al](http://ëëë.kzln.org.al)*

*Facebook: Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme*

*Tëitter: KZLN\_CFFE\_Albania*




*Aneksi 1 Tabela e KZAZ-ve në të gjithë Shqipërinë*

Bashkia	Njësia Adm.	KZAZ	Bashkia	Njësia Adm.	KZAZ	Bashkia	Njësia Adm.	KZAZ
Malësi e madhe	Koplik	<b>1</b>	Tiranë	Nj. Bashkiake nr. 1	<b>31</b>	Mallakastër	Ballsh	<b>61</b>
Shkodër	Shkodër	<b>2</b>		Nj. Bashkiake nr. 2	<b>32</b>	Ura vajgurore	Ura vajgurore	<b>62</b>
	Shkodër	<b>3</b>		Nj. Bashkiake Nr. 3	<b>33</b>	Kuçovë	Kuçovë	<b>63</b>
	Shkodër	<b>4</b>		Nj. Bashkiake Nr. 4	<b>34</b>	Berat	Berat	<b>64</b>
	Shkodër	<b>5</b>		Nj. Bashkiake Nr. 5	<b>35</b>	Poliçan	Poliçan	<b>65</b>
	Vau i dejes	Bushat		<b>6</b>	Nj. Bashkiake nr. 6	<b>36</b>	Skrapar	Çorovodë
Pukë		<b>7</b>		Nj. Bashkiake nr. 7	<b>37</b>	Pogradec	Pogradec	<b>67</b>
Fushë arrëz		<b>8</b>		Nj. Bashkiake Nr. 8	<b>38</b>	Maliq	Maliq	<b>68</b>
Tropojë	Bajram curri	<b>9</b>		Nj. Bashkiake Nr. 9	<b>39</b>		Pustec	<b>69</b>
HAS(Krumë)	Krumë	<b>10</b>		Nj. Bashkiake Nr. 10	<b>40</b>	Devoll	Bilisht	<b>70</b>
KUKËS	Kukës	<b>11</b>		Nj. Bashkiake Nr. 11	<b>41</b>	Korçë	Korçë	<b>71</b>
LEZHË	Lezhë	<b>12</b>	Kavajë	Kavajë	<b>42</b>		Korçë	<b>72</b>
	Lezhë	<b>13</b>	Rrogozhinë	Rrogozhinë	<b>43</b>	Kolonjë	Ersekë	<b>73</b>
KURBIN	Laç	<b>14</b>	Peqin	Peqin	<b>44</b>	Këlcyrë	Përmet	<b>74</b>
MIRDITË	Rrëshen	<b>15</b>	Belsh	Belsh	<b>45</b>	Përmet	Këlcyrë	<b>75</b>
Mat	Burrel	<b>16</b>	Cërrik	Cërrik	<b>46</b>	Memaliaj	Memaliaj	<b>76</b>
Klos	Klos	<b>17</b>	Elbasan	Elbasan	<b>47</b>	Tepelenë	Tepelenë	<b>77</b>
Bulqizë	Bulqizë	<b>18</b>		Elbasan	<b>48</b>	Gjirokastër	Gjirokastër	<b>78</b>
Dibër	Peshkopi	<b>19</b>		Elbasan	<b>49</b>	Libohovë	Libohovë	<b>79</b>
Krujë	Krujë	<b>20</b>		Elbasan	<b>50</b>	Dropull	Jorgucat	<b>80</b>
Durrës	Sukth	<b>21</b>	Gramsh	Gramsh	<b>51</b>	Vlorë	Vlorë	<b>81</b>
	Durrës	<b>22</b>	Librazhd	Librazhd	<b>52</b>		Vlorë	<b>82</b>



KOALICIONI PËR ZGJEDHJE TË LIRA  
E TË NDRERSHME E PËR DEMOKRACI  
TË QENDRUESHME



Shijak	Durrës	23	Prrenjas	Prrenjas	53	Selenicë	Vlorë	83
	Durrës	24	Lushnjë	Lushnjë	54		Vlorë	84
	Shijak	25	Lushnjë	Lushnjë	55		Kotë	85
Vorë	Vorë	26	Divjakë	Divjakë	56	Himarë	Himarë	86
Kamëz	Kamëz	27	Fier	Fier	57	Delvinë	Delvinë	87
	Paskuqan	28		Fier	58	Sarandë	Sarandë	88
Tiranë	Kashar	29	Patos	Patos	59	Livadhja	Dermish	89
	Bërzhitë	30	Roskovec	Roskovec	60	Konispol	Konispol	90